

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

TIRANA EAST GATE SH.P.K.

Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K82231001H

Me seli të regjistruar në adresën: Qendra Tregtare TEG, Rruga Nacionale Tiranë- Elbasan, Farkë, Lundër,
Tiranë

VENDIM

!


ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME

Sot më datë **24.03.2023** (dy mijë e njëzet e tre) në orën 10:00, në adresën: Qendra Tregtare TEG, Rruga Nacionale Tiranë – Elbasan, Farkë, Lundër, Tiranë”, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Tirana East Gate” Sh.p.k., e themeluar dhe organizuar ne përputhje me legjislacionin shqiptar e regjistruar ne Regjistrin Tregtar shqiptar, mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi NUIS K82231001H, (më tej referuar si “Shoqëria”).

Në mbledhje janë të pranishëm:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.** (“Balfin”), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Kati 12, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor, **Znj. Edlira Muka**, shtetase shqiptare, e lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034271384, dhe me numër personal I35203147R, (“Balfin”) ortakë e Shoqërisë dhe zotëruese e 88,095 kuotave (tetëdhjete e tetë pikë zero nëntëdhjetë e pese) që përfaqësojnë 88.095% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Albanian-American Enterprise Fund (“AAEF”)**, një organizatë jofitimprurëse e themeluar sipas ligjeve të shtetit Delaware në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me seli në: 780 Third Avenue, 46th floor, New York, NY 10017, USA dhe me zyrë përfaqësimi në Rrugën “ Ibrahim Rugova” Ndertesa nr. 42, Hyrja no. 7, Apart. No. 60, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar ligjërisht nga Z. Aleksandër Sarapuli, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër, Shqipëri, më 04.07.1963, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034346361 dhe Z. Martin Mata, lindur në Elbasan, Shqipëri, më 26.08.1966, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034059588 (ne vijim e quajtur edhe “AAEF”). – zotëruese e 8,905 (tetë pikë nëntëqind e pesë) kuotave që përfaqësojnë 8,905% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Shoqëria FINANCIAL INVESTMENT SERVIS (“FIS”)**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L21812018J, me seli të regjistruar në adresë: Autostrada Tirane Elbasan, km.0, Zyra brenda restorant Veranda, kati 1, pranë TEG, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht nga Z. Vahid Ruli (ne vijim e quajtur edhe “FIS”). – zotëruese e 3 (tre) kuotave qe përfaqësojnë 3% (tre përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Balfin, AAEF dhe FIS në vijim referuar së bashku edhe si “Ortakët”.



Znj. Edlira Muka në cilësinë e kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme, fton Znj. Eva Veizaj, dhe kjo e fundit pranon të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e Asamblesë, deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83, të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm parashton se Kapitali aktual i Shoqërisë është **3.353.338.000,00 LEK** (Tre miliardë e treqind e pesëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë lekë). Për motive operationale është parë e arsyeshme zvogëlimi i vlerës së kapitalit të regjistruar të Shoqërisë me një vlerë prej 10,000,000 EUR (dhjetë milion euro) ose një vlerë prej 1,142,100,000 LEK (një miliard e njëqind e dyzet e dy milion e njëqind mijë lekë) sipas kursit të këmbimit Euro – Lekë 114.21. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë do të kryhet në përpjestim me kontributin e secilin ortak.

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Asambleja e Përgjithshme:





VENDOS:

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me një vlerë prej 10,000,000 EUR (dhjetë milion euro) ose një vlerë prej 1,142,100,000 LEK (një miliard e njëqind e dyzet e dy milion e njëqind mijë lekë) sipas kursit të këmbimit Euro – Lekë prej 114.21. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë pas zvogëlimit do të jetë në vlerën **2,211,238,000 LEK (dy miliard e dyqind e njëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e tetë mijë lekë)**. Kontributi i secilin ortak në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë pas zvogëlimit do të jetë si më poshtë vijon:
- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k**, i cili zotëron 88.095% të kuotës së Shoqërisë, do të ketë një kontribut prej 13,522,582.50 EUR ose një kontribut prej 1,947,990,116 LEK (një miliard e nëntëqind e dyzet e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë lekë) sipas kursit të këmbimit Euro – Lekë 114.21;
 - **Albanian-American Enterprise Fund**, i cili zotëron 8,905% të kuotës së Shoqërisë, do të ketë një kontribut prej 1,366,917.50 EUR ose një kontribut prej 196,910,744 LEK (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e e nëntëqind e dhjetë mijë shtatëqind e dyzetë e katër lekë) sipas kursit të këmbimit Euro – Lekë 114.21;
 - **FINANCIAL INVESTMENT SERVIS**, i cili zotëron 3% të kuotës së Shoqërisë do të ketë një kontribut prej 460,500.00 EUR (treqind mijë euro) ose një kontribut prej 66,337,140 LEK (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzetë lekë) sipas kursit të këmbimit Euro – Lekë 114.21.
- B. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë për kryerjen e të gjitha aplikimeve të nevojshme online në portalin e-albania, me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit brenda muajit Prill 2023, veprime të cilat mund të kryhen personalisht prej tij ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.
- C. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë për kryerjen e të gjitha kontabilizimeve dhe shpërndarjeve të nevojshme që rrjedhin nga hyrja në fuqi e këtij vendimi brenda muajit Prill 2023.

Meqenëse nuk kishte çështje të tjera për tu shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 10.30. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
TIRANA EAST GATE SH.P.K.

LISTË PREZENCA

EMRI	CILËSIA	POZICIONI NË ASAMBLE	FIRMA
Edlira Muka	Përfaqësuese ligjore e Ortakut Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k	Kryetar	
Vahid Ruli	Përfaqësues ligjor i Ortakut Financial Investment Servis ("FIS")	Anëtar i Pranishëm	
Martin Mata	Përfaqësues i Ortakut Albanian-American Enterprise Fund - Drejtor Dega ne Shqipëri	Anëtar i Pranishëm	
Aleksandër Sarapuli	Përfaqësues i Ortakut Albanian-American Enterprise Fund - Drejtor Dega ne Shqipëri	Anëtar i Pranishëm	
Eva Veizaj	Juriste Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k	Sekretar	